



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Kuvendi i Komunës së Vitisë
Skupstina opstina Vitina
Municipal Assambly Vitina

Në bazë të nenit 40 paragrafi 2 pika b të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35 paragrafi 2 pika b të Statutit të Komunës së Vitisë 013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 21.10.2011 aprovon këtë:

V E N D I M
PËR RIALOKIMIN E MJETEVE KAPITALE BRENDA PROGRAMEVE

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë lejon rialokimin e mjeteve brenda programeve – rialokimi i mjeteve për projekte kapitale gjegjësisht bartjen e mjeteve prej një projekti në projektin tjetër dhe atë:

Fondi burimor 10

Në kuadër të njëjtit program **Buxhet e financa (175)** nënprogrami (17533) :

1. Nga projekti **Asfaltimi i rrugës “Elena Gjika” në Viti** kodit (83373) shuma prej - 4010 € të rialokohet në projektin e ri „ *Furnizimi me pajisje mjekësore* “ në shumë prej 4010 € .
2. Nga projekti „ **Ndërtimi i objektit për shoqatën e gjahtarëve** “ kodit (81866) shuma prej - 3000 € të rialokohet në projektin e ri „ *Furnizimi me pajisje mjekësore* “ në shumë prej 3,000 € .
3. Nga projekti „ **Furnizimi dhe montimi i trafostacioneve elektrike** “ kodit (83362) shuma prej - 17,000 € të rialokohet në dy projekte të reja
a „ *Furnizimi me pajisje mjekësore* “ në shumë prej 15,000 € .
b „ *Asfaltimi i rrugës së lagjes Halabaku – Pozheran,* në shumë prej 2,000€ .

Rialokimi i projekteve kapitale

Fondi burimor 21

Në kuadër të njëjtit program **Buxhet e financa (175)** nënprogrami (17533) :

4. Nga projekti „ **Rregullimi i murit mbrojtës të shk ,fill,-Remnik** “ kodit (83377) shuma prej -2002 € të rialokohet në projektin e ri „ *Furnizimi me pajisje mjekësore* “ në shumë prej 2002 € .
5. Nga projekti „ **Participim i projekteve me donator dhe komunitete** “ kodit (83355) shuma prej -19,498 € të rialokohet në një projekt të ri „ *Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Sodovinë e Jerlive* ‘ në shumë prej 19,498 € .
6. Në kuadër të njëjtit program shëndetësi dhe mirëqenie sociale (730) nënprogrami (73042) nga projekti „Meremetimi i nyjeve sanitare në QKMF Viti,“ kodit 83982 shuma prej -4,500€ të rialokohet në projektin, „ *Asfaltimi i rrugës së lagjes Halabaku – Pozheran,* në shumë prej 4.500€, projekt i ri.

Rialokimi i projekteve kapitale

Fondi burimor 22

Në kuadër të njëjtit program Arsim dhe shkencë (920) nënprogrami (92165) si vijon

7. Nga projekti „ **Asfaltimi i fushës sportive-Remnik**“kodi (81868) shuma prej 10,772 € të rialokohet në projekt të ri dhe një ekzistues si vijon :

- a) „ **Furnizimi me gypa të ujësjellësit - Debeldeh** “ në shumë prej 7,100 € projekt i ri .
- b) „ **Ndërtimi i katit të dytë të shk .fill –Ramjan** “ kodit (83376) në shumë prej 3,672 € projekt ekzistues.

8. Në kuadër të njëjtit program **Arsim dhe shkencë (920)** nënprogrami (92165) nga projekti „ **Asfaltimi i fushës sportive te shkolla e mesme -Viti** “kodi (81869) shuma prej 11,000 € të rialokohet në projektin ekzistues „ **Ndërtimi i katit të dytë të shk .fill –Ramjan** “ kodit (83376) në shumë prej 11,000 € .

Neni 2

Pas lejitimit të rialokimit të mjeteve nga neni 1 i këtij vendimi nga Ministria e Financave, Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë do të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi .

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi pas lejitimit të rialokimit të mjeteve nga Ministria e Financave, miratimit nga Kuvendi dhe nënshkrimin nga ana e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

01.Nr. _____
Viti, 21 10.2011



KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibaj